



Prishtinë, 10 prill 2015
Kodi i ZRRE-së: V_731_2015

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 14 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Kërkesat nga Kodi i Rrjetit – Kodi i balancit,
- Rregullat e Tregut – neni 13,
- Kërkesën e KOSTT për aprovimin e dokumenteve për prokurimin e shërbimeve ndihmëse të datës 17 mars 2015,

në seancën e mbajtur me datë 10 prill 2015, nxori këtë:

V E N D I M

I **Aprovohen** dokumentet për prokurimin e shërbimeve ndihmëse:

- o *Kushtet e Përgjithshme për Shërbimet Ndhmëse;*
- o *Shpjegime për kontratat e shërbimeve ndihmëse dhe udhëzimet tenderuese;*
- o *Kriteret për vlerësimin e ofertave për shërbimet ndihmëse;*
- o *Ftesë për tender për ofrimin e shërbimeve ndihmëse për vitin [yyyy].*

Arsyetim

KOSTT me 23 janar 2014 ka dërguar në ZRRE dokumentet për tenderimin e shërbimeve ndihmëse për komentim dhe pas përfshirjes së komenteve të ZRRE-së, me datë 17 mars 2015 KOSTT ka dërguar dokumentet e korrigjuara me kërkesën për aprovimin e këtyre dokumenteve për prokurimin e shërbimeve ndihmëse.

ZRRE ka bërë vlerësimin e dokumenteve dhe konsideron se i plotësojnë kriteret e nevojshme për të qenë si rregulla bazë për kryerjen e aktivitetit të prokurimit të shërbimeve ndihmëse, kështu që e ka parë të arsyeshme që të **Aprovohen** dokumentet për tenderimin e shërbimeve ndihmëse:

- Kushtet e Përgjithshme për Shërbimet Ndhmëse;*
- Shpjegime për kontratat e shërbimeve ndihmëse dhe udhëzimet tenderuese;*
- Kriteret për vlerësimin e ofertave për shërbimet ndihmëse;*
- Ftesë për tender për ofrimin e shërbimeve ndihmëse për vitin [yyyy].*




- II Për dokumentin *Shablloni i kontratës për shërbimet ndihmëse dhe Forma e tenderimit*, Bordi i ZRRE-së konsideron se nuk është për aprovim, por që nevojitet që KOSTT të dërgoi dokumentin ***Marrëveshja (e standardizuar) për shërbime ndihmëse*** për miratim.
- III Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së


Enver Halimi, kryesues


Merita Kostari, anëtare


Krenar Bujupi, anëtar